



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK GJIROKASTËR



NR 08, DATË 31 : 01, 2024

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE
AFATMESME 2025-2027”**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.01.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për miratimin e raportit të vlerësimit të të ardhurave afatmesme 2025-2027”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtiisë e pushtetit vendor” si dhe në mbështetje të VKB nr 106, datë 14.12.2023 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”.

V E N D O S I

1. Të miratojë raportin e vlerësimit të të ardhurave afatmesme 2025-2027 sipas dokumentit bashkëngjitur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Gjirokastrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

